



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2023:027973

Datë: 04.09.2024

Numri i dokumentit: 06123564

P.nr.12/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Sadri Krasniqi, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Donjeta Zenuni, në çështjen penale kundër të pandehurit G.H., nga, për shkak të veprës penale: falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par.1 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.II.nr.159/2023 të datës 30.01.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 19.08.2024, me datë 20.08.2023, publikisht shpalli, ndërsa më datën 04.09.2024 hartoi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

G. H. ,pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati S.dhe e ëma Y. e lindur S., i lindur më datë, në, , me nr. personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa martuar, i punësuar në botën e jashtme, i gjendjes së mesme ekonomike, sipas deklaratës së tij nuk ka qenë i dënuar më parë për vepër tjetër penale dhe nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

Ë s h t ë f a j t o r

Më datë 22.Tetor 2022, rreth orës 10.40 min, në pikën kufitare Dheu i Bardhë , i pandehuri G. H. , me dije ka përdorur dokumentin e fallsifikuar, ashtu që me rastin e verifikimit nga ana e zyrtarëve policor të udhëtarëve në autobusin e kompanisë Try Tours, e linjës ndërkombëtare Kosovë- Gjermani, i njëjti ka prezentuar lëjen e qëndrimit të shtetit të Francës me numër ,në emër të të njëjtit , i cili dokument më pas ka rezultuar që është i

fallsifikuar ,në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e tij ka përdorë si origjinal dokumentin e fallsifikuar

-me çka ka kryer veprën penale, Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 paragrafi 1 të KPRK-ës,

Gjykata në bazë të neneve 4, 38, 40, 43, 69 dhe 70 të KPRK-së, lidhur me nenin 242, 269 par.1, 364 dhe 452, të KPPRK-së, të pandehurin e lartcekur, e

G J Y K O N

- me dënim me gjobë në shumën prej **300 € (treqind euro)**, të cilën shumë, do ta arkëtoj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi **në tri këste mujore**, në të kundërtën nëse i pandehuri nuk e paguan këtë dënim me gjobë i njëjti dënim me gjobë do ti zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për çdo 20 €, do ti llogaritet një ditë burg.

Të pandehurit i Konfiskohet leja e qëndrimit e lëshuar nga autoritetet franceze me numër të sekuestruar sipas nr. të rastit 2022-YEK-016 të datës 22.10.2022 dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të konfiskuar me të njëjtin automjet do të veproj konform dispozitave ligjore përkatëse.

Obligohet i akuzuari, që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Njashtu i akuzuarit obligohet që në kuptim të nenit 36, paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimin, të arkëtoj shumën prej nga 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, më datën 159/2023 ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.30.01.2023, ka kërkuar që ndaj të pandehurit G.H., nga të fillohet dhe shtjellohet procedura penale, për shkak të veprës penale: falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par.1 të KPRK-së, të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata shqyrtoi aktakuzën dhe pas vlerësimit të së njëjtës dhe shkresave tjera të lëndës konstatoi se e njëjta është e bazuar në ligj, andaj duke vepruar sipas të njëjtës, ka caktuar seancë gjyqësore për shqyrtim fillestar kundër të pandehurit për datën 19.08.2024. Në të cilën

seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shteti, i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, njëherit thekson se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë.

Prokurorja e shtetit Rozelida Manastiri, nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, njëherit thekson se janë plotësuar kushtet ligjore për pranimin e fajësisë nga i pandehurit me veprën penale me të cilën akuzohet sipas aktit akuzues.

Gjykata pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka aprovuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, gjykata ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në të cekurat më lartë, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se i pandehuri G. H. me dashje ka kryer veprën penale, falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për të cilën vepër penale, gjykata të pandehurin e shpalli fajtor, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj veprave penale dhe se për të njëjtën është edhe penalisht përgjegjës.

Pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë, gjykata nuk është lëshuar fare në administrimin e provave të propozuara si në aktakuzë, por drejtë është shkuar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurorja e shtetit në fjalën përfundimtare deklaron se bazuar në pranimin e fajësisë dhe të provave materiale që ndodhen në shkresat e lëndës, i propozon gjykatës që tani të akuzuarin G. H. ta shpall fajtor dhe ta dënojë me një dënim meritore sipas ligjit i cili dënim do të jetë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj veprë penale. Gjithashtu i propozon gjykatë me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të ketë parasysh të gjitha rrethanat si ato lehtësuese po ashtu edhe ato rënduese, si rrethana lehtësuese gjykata të merr për bazë faktin se i njëjti për herë të parë bie ndesh me ligjin, pendimin për kryerjen e kësaj veprë penale, gjendjen ekonomike si dhe ndonjë rrethanë tjetër lehtësuese nëse gjen gjykata, ndërsa si rrethana rënduese gjykata të merr për bazë dashjen dhe mënyrën e kryerjes së kësaj veprë penale, shkallën e përgjegjësisë penale si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj veprë penale, si dhe konform nenit 270 par.1

të KPPK-së, leja e qëndrimit e lëshuar nga autoritet franceze me nr.5703118190 në emër të të pandehurit të konfiskohet.

I akuzuari në fjalën përfundimtare deklaroi se e pranon fajësinë, ka gabuar, është penduar, i premtonte gjykatës se më nuk do ta përsërisë veprën penale, këtë e ka bërë për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike në të cilën jeton, me qëllim që të sigurojë një jetë më të mirë për vete dhe familjen e tij. Andaj kërkon nga gjykata që mundësisht të i shqiptojë një dënim sa më të butë konform ligjit dhe nëse më shqipton dënim me burg të njëjtin dënim t'ia zëvendësojë në dënim me të holla.

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit ti shqiptohet dënim si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesve dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës. Gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që rrethanë lehtësuese për të pandehurin gjykata pati parasysh pranimin e fajësisë nga i njëjti në një fazë të hershme të procedurës penale, pendimin për kryerjen e veprës penale, po ashtu gjykata pati parasysh edhe gjendjen e tij të vështirë ekonomike dhe se këtë e ka bërë për shkak të kushteve të vështira ekonomike, me qëllim që të sigurojë një jetë më të mirë për vete dhe familjen e tij. Gjykata po ashtu ka marrë parasysh edhe rrethanat personale dhe karakterin e të pandehurit ku nga shkresat e lëndës shihet se për të pandehurit është hera e parë që bien ndesh ligjin, premtimi i tij gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale. Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata pati parasysh shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, peshën e veprës penale të kryer dhe mënyrën e kryerjes së saj.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ndaj të pandehurit G.H., duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se me dënimet e shqiptuara ndaj të pandehurit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Konform dispozitave ligjore të nenit 269 par.1 të KPRK-së, të pandehurit i konfiskohet leja e qëndrimit e lëshuar nga autoritetet franceze me numër e sekuestruar sipas nr. të rastit 2022-YEK-016 të datës 22.10.2022 dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të konfiskuar me të njëjtin automjet do të veproj konform dispozitave ligjore përkatëse.

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarit, gjykata, bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të KPPRK-së, ka vendosur që të akuzuarin ta detyrojë për ta paguar paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (Njëzetë euro), si dhe a 20 € për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Pas shpalljes së aktgjykimit, në kuptim të nenit 367 të KPPRK-së palët janë udhëzuar për të drejtën në ankesë.

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2023:027973, 04.09.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues,

Sadri Krasniqi,d.v.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Kamenicë.